

**MENAXHIMI I INTEGRUAR I BURIMEVE UJORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NË PËRPUTHJE ME
KËRKESAT E DIREKTIVËS KUADËR TË UJIT 2000/60/EC
*BASENI VJOSË***



AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

17 - 21 QERSHOR 2019

PËRMBAJTJA

- INFORMACION I PËRGJITHSHËM
- DIREKTIVAT E BE-së
- LEGJISLACIONI KOMBËTAR
- KUADRI INSTITUCIONAL
- MENAXHIMI I UJËRAVE NDERKUFITARE
- BASENET UJORE NDËRKUFITARE
- BASENIT I LUMIT VJOSË SI BASEN NDËRKUFITAR
- ROLI I KBU/ZABU NË MENAXHIMIN E UJËRAVE NDËRKUFITARE
- PRIORITETET

INFORMACION I PËRGJITHSHËM



Uji nuk është një produkt tregtar si gjithë të tjerët, por është një trashëgimi e cila duhet të ruhet, mbrohet dhe të trajtohet si e tillë.

Territori i Republikës së Shqipërisë, në funksion të administrimit të burimeve ujore, ndahet në 6 basene ujore:

1. Drin-Buna
2. Mat
3. Ishëm-Erzen
4. Shkumbin
5. Seman
6. Vjosë

DIREKTIVAT E BE-së – NË FUSHËN E UJËRAVE

- **Direktiva Kuadër e Ujit 2000/60/EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2000 për “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave”, amenduar nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU2013/64/EC dhe 2014/101/EU.
- **Direktiva e Këshillit 98/83/EC** e datës 3 nëntor 1998 për “Cilësinë e ujit të pijshëm”, amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 596/2009 si dhe nga Direktiva 2015/1787/EC.
- **Direktiva 91/676/EEC** e datës 12 dhjetor 1991 për “Mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratat e përdorura në bujqësi” amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008.
- **Direktiva 2007/60/EC** e datës 23 tetor 2007 për “Vlerësimin dhe manaxhimin e rrezikut nga përmbytjet”.
- **Direktiva 2008/56/EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 qershor 2008 për “Krijimin e një kuadri në fushën e politikave mjedisore detare” (direktiva për kuadrin e strategjisë detare).

LEGJISLACIONI KOMBËTAR

- Ligj nr. 111/2012 për “Menaxhimin e Integruar të burimeve ujore” (i ndryshuar)
- Ligji Nr. 9103 për “Mbrojtjen e liqeneve ndërkufitar”
- Ligji Nr.9115 “Për trajtimin e ujrave të ndotur urban”
- Ligji Nr.8905 “Mbrojtja e ujërave detar nga ndotja dhe dëmtimi”
- Ligj Nr. 91/2013 për “Vlerësimin Strategjik Mjedisor”
- Ligj Nr. 9700, datë 26.3.2007 për “Mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare”
- Vendim Nr. 598, datë 1.7.2015 për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitare”
- VKM Nr.416 datë 13.5.2015, për “Miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatin e vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”

DOKUMENTAT POLITIKO-STRATEGJIKË NË FUSHËN E UJIT

- Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018-2027
- Draftet finale të planeve të menaxhimit të baseneve ujore Drin-Bunë dhe Seman
- Draft VKM për miratimin e Kadastrës Kombëtare të burimeve ujore

KUADRI INSTITUCIONAL

- Menaxhimi i Burimeve Ujore ne nivel qendror bëhet nëpërmjet:
 - ✓ Këshillit i Ministrave
 - ✓ Këshillit Kombëtar i Ujit i përbërë nga ministritë përgjegjëse për burimet ujore dhe kryesohet nga Kryeministri
 - ✓ Agjensisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore
- Menaxhimi i ujërave në nivel vendor bëhet nëpërmjet:
 - ✓ Këshillave të Baseneve Ujore
 - ✓ Zyrave të Administrimit të Baseneve Ujore, degë të AMBU-së

MENAXHIMI I UJËRAVE NDËRKUFITARE


Menaxhimi i ujërave ndërkufitar kryhet në zbatim të ligjit 111/2012 I ndryshuar dhe VKM nr. 177 datë 26.3.2014 “Për ngritjen, përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë dhe detyrat e Komisionit të posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitare” (e ndryshuar..) dhe në respekt të :

- Konventa ESPOO për “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar“ e vitit 1991;
- Konventa e Helsinkit “Për mbrojtjen dhe përdorimin e ujërave ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare”, e vitit 1992.
- Konventa e Barcelonës “Mbrojtja e mjedisit detar dhe rajonit bregdetar të Mesdheut” e vitit 1995
- Memorandumi i mirëkuptimit Drin: vizioni i përbashkët strategjik 2011, midis vendeve fqinje: Mali i Zi, Kosovë, Shqipëri, Greqi dhe Maqedoni .
- Marrëveshja Kuader ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për marrëdhëniet e ndërsjellta në menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare.

BASENET UJORE NDËRKUFITARE

- Në territorin e Shqipërisë dy basene ujore janë në nivel ndërkufitar:
 - Baseni ujqor Drin-Bunë ndahet me Maqedoninë, Greqinë, Malin e Zi dhe Kosovën;
 - Baseni ujqor Vjosa ndahet me Greqinë.
- Shqipëria ka tre liqene kryesore të cilët janë në nivel ndërkufitar:
 - Liqeni i Shkodrës, i ndarë me Malin e Zi;
 - Liqeni i Ohrit, i ndarë me Maqedoninë;
 - Liqeni i Prespës, i ndarë me Greqinë dhe Maqedoninë.

BASENI I LUMIT VJOSË SI BASEN NDËRKUFITAR



- Lumi Vjosa është lumi i dytë më i madh në Shqipëri me rreth 6,808 km² pellg ujëmbledhës ku rreth 1/3 është në territorin Grek.
- Vjosa është një nga lumenjtë më të gjatë ndërkufitar në Ballkan me një gjatësi prej 85 km në territorin Grek dhe 190 km në Shqipëri, me popullsi afërsisht 190.000 banorë
- Klima: e thatë dhe e ngrohtë në verë dhe e lagësht në dimër
- Lumi Vjosa (Aoös) ka tri degë kryesore, Sarantaporos në Greqi, Drinos që shtrihet në të dy shtetet dhe Shushica në Shqipëri.



- Ka vlera të mëdha ekologjike dhe potencial ekonomik.
- I cënuar ndaj impakteve të zhvillimit dhe ndryshimeve klimatike:
 - Përmytjet;
 - Thatësira.
- Nuk ka plan menaxhimi për basenin ujqor.

PRIORITETET

Në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Integrit, fusha e ujërave është një nga prioritetet e qeverisë. Në këtë kuadër menaxhimi i ujërave ndërkufitare ka një rëndësi të veçantë.

Prioritetet në këtë fushë do të jenë:

- Zhvillimi i diskutimeve me strukturat përkatëse të palës Greke e bisedimeve për arritjen e një marrëveshje.
- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e tjera të ngritura për çështje të tjera mjedisore (grupe pune/komisione/zonat e mbrojtura, etj.)
- Realizimi i detyrave dhe përgjegjësi në përputhje me kuadrin ligjor (ndërkombëtar dhe ai kombëtar)
- Forcimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore në nivel baseni për realizimin e planeve të menaxhimit dhe shkëmbimin e të dhënave me vendet fqinje.



FALEMINDERIT

